



# OPOZITA SHPREH SHQETËSIME PËR RAPORTIN E DËMTUAR TË QEVERISË SË KOSOVËS ME SHBA-në | FAQE 4-5



Zëvendësndihmëssekretari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Alexander Kasanof, ka vizituar për herë të parë në rolin e tij aktual Kosovën dhe rajonin. Ai në kuadër të kësaj vizite ka takuar liderët e shtetit dhe ata

opozitarë, duke theksuar mbështetjen afatgjatë të ShBA-së për popullin e Kosovës si dhe duke kërkuar përparim në rrugën evropiane të Kosovës si një shtet sovran, i pavarur dhe shumëtnik. Liderët e opozitës gjatë takimit me

Kasanofin kanë ritheksuar nevojën e shtetit të Kosovës për bashkërendim të qëndrimeve me aleatët strategjikë, veçanërisht me ShBA-në, gjithashtu shprehën shqetësimet e tyre për raportin e dëmtuar të Qeverisë së Kosovës me ShBA-në

**OPOZITA KËRKON  
HETIM PËR  
KOMUNIKIMIN E  
KUSARI-LILËS ME  
RADOJÇIQIN | F. 7**



**"DO TË NDËRPRITEN  
AKTIVITETET,  
USHTARËT JANË  
NË RREZIK TË  
HELMOHEN",  
KOMANDANTI I FSK-së  
I SHKRUAN LETËR  
MAQEDONCIT | F. 3**



## AKTUALE



**KRASNOI DHE HAMZA PËR  
25-VJETORIN E PDK-SË UROJNË  
THAÇIN DHE VESELIN | F. 3**

**LAJÇAKU DHE BISLIMI PO  
BASHKËPUNOJNË PËR TAKIMIN E  
RADHËS | F. 7**

**ALIU: KATËR KOMUNAT VERIORE  
JANË PJESË E AKK-së | F. 7**

**DEPUTETJA E LV-SË I BASHKOHET  
LDK-së | F. 7**

## EKONOMI



**GUVERNATORI ISMAILI: LUFTA  
KUNDËR FINANCIMIT TË PALIGJSHËM  
KËRKON NJË PËRPPJEKJE  
GJITHËPËRFSHIRËSE | F. 8**

**MINISTRI PECI MERR PJESË NË  
HAPJEN E PANAIRIT TË PRODUKTEVE  
TRADICIONALE DHE ARTIZANALE  
NË PODUJEVË | F. 8**

## SPORT



**FODA DHE RRAHMANI: NDAJ  
LITUANISË LUAJMË PËR FITORE | F. 10**

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Blinkeni ia përmend Izraelit rëndësinë e mbrojtjes së civilëve pas sulmeve në Bejrut

WASHINGTON, 11 TETOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka thënë se Uashingtoni është ende duke punuar për ta parandaluar një luftë të madhe në Lindje të Mesme, dhe i ka bërë thirrje Izraelit t'i mbrojtë civilët, pasi 22 njerëz janë vrarë nga sulmet në qendër të Bejrutit. Blinkeni ka folur një ditë pasi sulmet ajrore izraelite kanë shënjestruar dy ndërtesa në Bejrut, njëra prej të cilave është shkatërruar plotësisht. "Ne vazhdojmë të angazhohemi intensivisht për të parandaluar një konflikt më të gjerë në rajon", u ka thënë Blinkeni gazetarëve pas një Samiti të Azisë Lindore në Laos, duke shtuar se është "shumë me rëndësi" për Izraelin që të garantojë se civilët janë të mbrojtur gjatë konfliktit. Burimet libaneze kanë thënë se të paktën një figurë e lartë e Hezbollahut është shënjestruar në sulme, të tretat me radhë në

Bejrut, prej kur Izraeli ka nisur fushatën në jug të Libanit, muajin e kaluar, kundër milicisë së Hezbollahut, të përkrahur nga Irani. Këto veprime kanë rritur frikën për ndonjë luftë të madhe rajonale. Hezbollahu, grup militant dhe parti politike që kontrollon pjesën më të madhe në jug të Libanit, është shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara, derisa Bashkimi Evropian e ka në listë të zezë vetëm krahun e armatosur, por jo partinë e cila ka ulëse në Parlamentin e Libanit. Televizioni Al-Manar i Hezbollahut ka thënë pas sulmeve se tentimet për ta vrarë Wafiq Safanin, një zyrtar të lartë të sigurisë së grupit, kanë dështuar. Në raportime është thënë se Safa nuk ka qenë në asnjërën prej ndërtesave të shënjestruara. Safa udhëheq një departament



përgjegjës për të punuar me agjencitë e sigurisë së Libanit, kanë thënë burimet. Në një tjetër incident, më 10 tetor, forcat paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara në jug të Libanit,

kanë thënë se një tanke izraelite ka goditur ndërtesën ku gjendet selia e tyre në qytezën Naqoura dhe, për pasojë, janë plagosur dy paqeruajtës. Kombësia e paqeruajtësve nuk

është bërë me dije. Misioni i Kombeve të Bashkuara ka thënë përmes një deklarate se si pasojë e sulmeve izraelite janë dëmtuar edhe makinat, si dhe një sistem komunikimi.

## Obama u bënë thirrje burrave me ngjyrë që ta përkrahin Harrisin

WASHINGTON, 11 TETOR - Ish-presidenti amerikan Barack Obama e ka kritikuar sërish pasardhësin e tij në Shtëpinë e Bardhë, Donald Trump, dhe u ka bërë thirrje burrave me ngjyrë që ta përkrahin kandidaten e demokratëve, Kamala Harris, teksa ka bërë fushatë në Pitsburg të Pensilvanisë, njërit prej shteteve të lëkundshme në zgjedhje. Obama ka thënë se dëshiron t'i flasë "disa të vërteta", pasi ka dëgjuar raportime në terren se ka më pak entuziazëm për Harrisin, në krahasim me kur ka qenë kandidat vetë, dhe që burrat me ngjyrë po mendojnë që të mos votojnë në këto zgjedhje. "Një pjesë e imja më bën të mendoj - dhe po u flas burrave direkt që nuk jeni duke e ndier idenë që të keni një grua si presidente, prandaj po dilni me alternativa të tjera dhe arsye të tjera", ka thënë Obama. Ish-presidenti ka thënë se taktika e Trumpit për t'i ulur njerëzit nuk është forca e tij e vërtetë. "Po e



shqyrtoni mundësinë që të rini larg zgjedhjeve, apo të mbështesni dikë që historikisht ju ka denigruar juve, sepse besoni që ajo është shenjë e forcës, sepse ashtu duhet të jetë një burrë? Duke i ulur gratë? Kjo është e

papranueshme", ka thënë Obama. Ish-presidenti demokrat ka nisur të vizitojë shtetet që lëkundën në qëndrimet e tyre në këto zgjedhje, teksa kanë mbetur më pak se katër javë deri te dita kryesore e votimit.

Duke folur në Universitetin e Pitsburgut, Obama e ka përkrahur Trumpin si njeri jashtë realitetit, ndërsa Harrisin si "lidere që ka kaluar jetën duke luftuar në emër të njerëzve që kanë nevojë për zë dhe një mundësi", dhe

beson që "Kamala është e përgatitur për këtë punë". Obama, i cili e ka përfunduar mandatin tetë vjet më parë, është një prej zërave më me ndikim në Partinë Demokratike. Derisa është zgjedhur president, më 2020, edhe Joe Biden e ka pasur atë ndikim te demokratët, mirëpo këtë vit, meqë është duke i dhënë fund mandatin, nuk është përfshirë në fushatë. Si Harris, ashtu edhe Trump, kanë qenë shumë të zëshëm për ta fituar mbështetjen e amerikanëve me ngjyrë. Një anketë e kryer së fundmi nga agjencia e lajmeve AP dhe Qendra NORC ka gjetur se shtatë në 10 votues me ngjyrë kanë një qasje në favor të Harrisit, më disa dallime të vogla në mesin e burrave me ngjyrë dhe grave, rreth asaj se si e shohin kandidaten demokrate. Mendimet e amerikanëve me ngjyrë, lidhur me Trumpin, janë kryesisht negative, sipas anketës.

## Grupi japonez kundër armëve bërthamore nderohet me Nobelin për Paqe

TOKIO, 11 TETOR - Çmimi Nobel për Paqe këtë vit i është dhënë grupit japonez Nihon Hidankyo, organizatë e të mbijetuarve të sulmeve me bombë atomike në Hiroshima dhe Nagasaki. Ata bëjnë thirrje vazhdimisht për braktisje të armëve bërthamore. "Rrënjët e lëvizjes së të mbijetuarve të bombave atomike në Hiroshima dhe Nagasaki, e njohur edhe si Hibakusha,

shpërblehet me Çmimin Nobel për Paqe, për përpjekjet për ta bërë një botë pa armë bërthamore, dhe duke na treguar si dëshmitarë që armët bërthamore nuk duhet të përdoren më kurrë", ka thënë Komiteti, teksa e ka shpallur fituesin. "Përpjekjet e jashtëzakonshme të Nihon Hidankyos dhe përfaqësuesve të tjerë të Hibakushas kanë kontribuar shumë për

krijimin e tabusë bërthamore". Komiteti Norvegjez i Nobelit e ka bërë dhënë lajmin të premtën nga Osloja, duke zgjedhur këtë grup në mes të 197 individëve dhe 89 organizatave të nominuara. Çmimi ka vlerën rreth një milion dollarë. Vitin e kaluar me këtë çmim është nderuar aktivistja iraniane për të drejtat e grave, Narges Mohammadi.



LËVIZJA VETËVENDOSJE NUK MERR PJESË NË SEANCËN E JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT PËR KOMUNIKIMIN E KUSARI-LILËS ME RADOJÇIQIN

## Opozita kërkon hetim për komunikimin e Kusari-Lilës me Radojçiqin

Deputetëve e partive opozitare në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit kanë adresuar kritika të ashpra ndaj Lëvizjes Vetëvendosje dhe kryeministrit Albin Kurti për komunikimin e shesës së deputetëve të partisë në pushtet, Mimoza Kusari-Lila, me kriminelin serb Milan Radojçiq. Në këtë seancë, ku kanë munguar deputetët e pushtetit, opozita ka kërkuar të hetohet nga prokuroria komunikimi në mes të Kusari-Lilës me Radojçiqin, i cili ka urdhër për arrestim dhe është në listën e zezë të Amerikës



Kurse Hykmete Bajrami, deputete e LDK-së, ka kërkuar hetim për krejt bisedën, duke pyetur se cilat ishin kostot e Kosovës nga ky koordinim. “Është e ndaluar që një person i qeverisë të bisedojë me kriminelin, e ajo e ka bërë këtë më vëmendje të plotë. Kjo duhet të hetohet se cilat kanë qenë kërkesat e Radojçiqit ndaj kryeministrit Albin Kurti... Cila është kostoja që Republika e Kosovës e ka paguar si pasojë e këtij koordinimi?”, ka thënë Bajrami.

Pas kësaj, deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu, i ka kërkuar llogari Kurtit edhe për një ngjarje tjetër, që ka ngjarë para më shumë se dy dekadave. “Prapa krejt kësaj masakrade dhe tradhtie kombëtare qëndron Albin Kurti, i cili, përveç takimit në Binç, duhet të japë edhe llogari si dhe pse vetëm ai nga të gjithë të burgosurit politikë shqiptarë ishte i falur dhe jo i liruar nga Kushtetuta”, ka thënë ai.

E deputeti i pavarur në Kuvendin e Kosovës, Haki Abazi, ka thënë se bisedat e Mimoza Kusari-Lila me Milan Radojçiqin janë taktika të kryeministrit Albin Kurti. “Ua kemi borxh shqiptarëve që t'i zbërthejmë deri në fund bisedat e Albin Kurti për ta mbërritur tensionin e mjaftueshëm për t'i manipuluar qytetarët”, ka thënë Abazi.

Audioincizimet që janë publikuar nga portali “Paparaci” në mes të Kusari-Lilës dhe Radojçiqit kanë të bëjnë me kalimin e Projektligjit për Pagën Minimale dhe për votimin e një kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese në qershor të 2022-s.

EPOKA  
ERE **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 10 TETOR** - Pa praninë e deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje është mbajtur të premtën seanca e jashtëzakonshme lidhur me komunikimin e shesës së deputetëve të partisë në pushtet, Mimoza Kusari-Lila me kryekriminelin serb, Milan Radojçiq.

Në këtë debat përfaqësuesit e partive opozitare kanë adresuar kritika të ashpra në drejtim të qeverisë dhe kryeministrit Albin Kurti. Në këtë drejtim ata kanë kërkuar hetim nga prokuroria për komunikimin e Kusari-Lilës me kriminelin Radojçiq.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se Vetëvendosja do të japë përgjegjësi se cila agjendë ka qenë ajo dhe cilat kërkesa ia kanë përmbushur pjesëtarit të BIA-s, Milan Radojçiq. “Të isha në pozitën e tyre, për besë ndoshta e kisha pasur rëndë të vija këtu dhe të ballafaqohesha me një çështje tepër të rëndë, por të vërtetës nuk mund t'i ikim. Sot po

ikin nga kjo seancë, por nesër nuk do të mund të ikim. Ata kanë me dhënë përgjegjësi, se cila agjendë ka qenë ajo dhe cilat kërkesa i kanë përmbushur pjesëtarit të BIA-s, Milan Radojçiqit”, ka thënë Tahiri. “Duhet hetim i thellë. Duhet parë ku ka mbërritur vendimmarrja që ka qenë e shtyrë nga Radojçiqi. Duke ditur se nuk kemi evidencë të votimeve, na pamundëson me pas situatë të qartë. I kërkoj prokurorit të shtetit që me pas hetim penal për këtë temë. BIA serbe na ka imponuar ligjet, na ka depërtuar deri në Gjykatën Kushtetuese. Nuk jemi cenuar asnjëherë më shumë se kësaj here”, ka thënë Tahiri.

Ndërsa deputeti i LDK-së, Anton Quni, ka thënë se Kusari-Lila me këtë veprim e ka turpëruar Kosovën para gjithë botës, ndërsa Kurtin e ka quajtur fajtorin kryesor. “I drejtohem zonjës Kusari-Lila: me besoni se po me dhimbjeni, seriozisht kam dhimbje për ju... Nuk jeni ju fajtori kryesor. Fajtori kryesor është lideri juaj, kryeministri Albin Kurti. Nuk e di sesi ju ka detyruar që ta aranzhoni

marrëveshje me kriminelin, krijesën e inteligjencës së Serbisë”, ka thënë Quni.

Ndërsa kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se ka pasur marrëveshje në mes të Listës Serbe dhe Vetëvendosjes për t'i larguar veteranët e UÇK-së nga paga minimale.

Më tutje, Haradinaj ka përsëritur akuzën e rëndë ndaj kryeministrit Albin Kurti, duke e quajtur spiun të Serbisë. “Marrëveshje Lista Serbe dhe Vetëvendosje për me i largu veteranët, kategoritë e lirisë, mos me u përfshi në pagën minimale e ka bërë Albin Kurti me Radojçiqin. Unë nuk them me Radojçiqin, por me Vuçiqin. Mos harroni këtë, këtu

dal te ajo që po ju them çdoherë, që Kurti është spiun i Serbisë. Është njeri i Serbisë”, ka thënë Haradinaj.

Në këtë debat kanë folur edhe disa deputetë të opozitës. Deputeti i AAK-së, Pal Lekaj, ka thënë se biseda e Kusari-Lilës me Radojçiqin është bërë me urdhrin e kryeministrit Albin Kurti dhe Dejana Mihalit, shefe e komiteteve të LV-së. “Me të drejtë i themi Mimosës që nuk i ke fajet ti, por fajet i ka kryeministri dhe kryetari i LV-së, që me urdhrat e tij ke vepruar. Fajet i ka Dejana, që në komunikim të vazhdueshëm jeni kanë me të dhe ju ka premtuar se do të keni mbështetje”, ka thënë Lekaj.

## Krasniqi dhe Hamza për 25-vjetorin e PDK-së urojnë Thaçin dhe Veselin

**PRISHTINË, 10 TETOR** - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, në 25-vjetorin e themelimit të partisë, ka thënë se kjo parti qëndron si testament se Kosova meriton të ekzistojë si shtet i pavarur, i zhvilluar dhe me perspektivë.

Krasniqi, duke i uruar për këtë përvjetor jubilar dy liderët, Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin, është shprehur se ndihet krenar për trashëgiminë politike të PDK-së. “Kur popullit tonë i cenohej identiteti, gjuha, shpresa dhe vetë ekzistenca, të rinjtë trima si Hashim Thaçi, Kadri Veseli e shumë bashkëveprimtarë dhe bashkëveprimtare të tyre, shumë prej të cilëve i kemi edhe sonte prezent këtu, u ngritën në këmbë dhe formuan Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, organizimin më të suksesshëm politiko-ushtarak në historinë tonë, si ADN-ja e partisë sonë. Këta trima vizionarë nuk e bënë luftën vetëm për trojet tona, sepse ajo ishte shumë më shumë se



aq. Ata bënë një luftë që ishte për të drejtën për të ekzistuar si popull i lirë. Kur lufta u fitua dhe armët heshtën, po ata udhëheqës e dinin se qëllimi ynë nuk ishte arritur ende. Dhe kështu, më 10 tetor të vitit 1999, shumë prej jush u organizuat politikisht për ta

formuar Partinë Demokratike të Kosovës, duke e ditur se ardhmja e Kosovës kishte nevojë për lidhshmëri dhe jo çfarëdo lidhshmëri, por lidhshmëri të fortë, të guximshme dhe vizionar. Siç e dimë të gjithë, pjesa tjetër është histori: Që nga ajo ditë, PDK-ja udhëhoqi detyrën për

të ndërtuar një Kosovë të re. Nën udhëheqjen tonë, ne ndërtuam shtetin e Kosovës nga brenda dhe i dhamë asaj një vend në botë. Çdo hap që hidhnim na afronte më shumë me të ardhmen që ëndërronim. Prandaj, derisa festojmë 25-vjetorin e Partisë Demokratike të Kosovës, ju lus të gjithëve që jeni sot që t'ia rikujtoni gjithmonë vetes një gjë: Partia Demokratike e Kosovës është një histori e jashtëzakonshme e dashurisë, sakrificës dhe kontributit për Kosovën!”, ka thënë ai.

Krasniqi ka rikujtuar se kur ndalet PDK-ja, ndalet Kosova, sepse PDK-ja, sipas tij, ka vënë Kosovën në hartën e botës, duke vendosur themelet e një shteti demokratik dhe perëndimor. “Krenohu me Kosovën. Ky ishte slogani, motivi dhe vizioni ynë me të cilin garuam dhe fituam zgjedhjet e vitit 2007. Vetëm disa muaj më pas, më 17 shkurt të vitit 2008, nën udhëheqjen e PDK-së, Kosova shpalli pavarësinë e saj, një pikë kthese historike jo

vetëm për ne, por edhe për brezat e ardhshme. Ishte Partia Demokratike e Kosovës ajo që ndërtoi rrugë dhe autostrada. Ishte Partia Demokratike e Kosovës ajo që ndërtoi shkolla dhe spitale. Ishte Partia Demokratike e Kosovës që rriti pagat dhe krijoi vende të reja të punës”, ka thënë Krasniqi, duke shtuar se sukseset e PDK-së ndër vite i kanë shqetësuar kundërshtarët e kësaj partie dhe të Kosovës.

Krasniqi u ka bërë thirrje të gjithë anëtarëve dhe mbështetësve të partisë që të mobilizohen për fitore në zgjedhjet e përgjithshme për ta arritur rilindjen e Kosovës.

Ndërsa kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, ka thënë se ka vullnetin, forcën dhe përgjegjësinë për t'u angazhuar që ta rikthejë Kosovën në rrugën e zhvillimit, për të cilën Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli kanë punuar dhe kanë sakrifikuar. “Ata (Thaçi dhe Veseli) e kanë dashur dhe e duan Kosovën...”, ka thënë Hamza.



## Opozita shpreh shqetësime për raportin e dëmtuar të Qeverisë së Kosovës me ShBA-në

Zëvendësndihmëssekretari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Alexander Kananof, ka vizituar për herë të parë në rolin e tij aktual Kosovën dhe rajonin. Ai në kuadër të kësaj vizite ka takuar liderët e shtetit dhe ata opozitarë, duke theksuar mbështetjen afatgjatë të ShBA-së për popullin e Kosovës si dhe duke kërkuar përparim në rrugën evropiane të Kosovës si një shtet sovran, i pavarur dhe shumetnik. Liderët e opozitës gjatë takimit me Kananofin kanë ritheksuar nevojën e shtetit të Kosovës për bashkërendim të qëndrimeve me aleatët strategjikë, veçanërisht me ShBA-në, gjithashtu shprehën shqetësimet e tyre për raportin e dëmtuar të Qeverisë së Kosovës me ShBA-në

**EPOKA E RE** Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 11 TETOR** - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim zëvendësndihmëssekretarin e ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Alexander Kananof. Në takim u diskutua për forcimin e mëtejshëm të aleancës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe për rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë për t'i përbashkëta strategjike.

Presidentja Osmani shprehu mirënjohjen e saj të thellë për përkrahjen e vazhdueshme të ShBA-së ndaj Kosovës, duke shtruar nevojën e dialogut

strategjik me ShBA-në, si një hap i rëndësishëm në fuqizimin e partneritetit, kërkesë kjo që ka vite që është përcjellë nga Osmani. Në këtë kontekst, Osmani nënvizoi rëndësinë e anëtarësimit të Kosovës në NATO, duke potencuar se një Kosovë e integruar në Aleancën Veri-Atlantike forcon sigurinë e vendit, por kontribuon edhe në stabilitetin e rajonit.

Në takimin me Kananof, presidentja Osmani diskutoi edhe për mundësinë e thellimit të bashkëpunimit në fusha të ndryshme me interes të ndërsjellë, siç është fusha e mbrojtjes dhe sigurisë.

Kananofin e ka pritur në takim

edhe kryeministri Albin Kurti, të cilit i uroi mirëseardhje në këtë vizitë të parë në vend, gjersa shprehu vlerësimin e lartë për marrëdhëniet e fuqishme bilaterale në mes të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe kontributit të tyre në çlirimin, pavarësimin dhe zhvillimin e shtetit tonë.

Kurti shtoi se me Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndajnë vlera dhe qëllime të përbashkëta, si miq, aleatë e partnerë, e cila reflektohet edhe nga dëshira e perceptimi edhe i qytetarëve të vendit tonë.

Kryeministri Kurti falënderoi Shtetet e Bashkuara të Amerikës për bashkëpunimin në fushën e

ekonomisë, energjisë, sigurisë e më gjerë. Theksoi edhe progresin demokratik, ekonomik e shoqëror që ka njohur vendi ynë përgjatë këtij mandati qeverisës, me ç'rast veçoi edhe rëndësinë e sigurisë dhe të sundimit të ligjit.

Kryeministri theksoi edhe domosdoshmërinë e bashkëpunimit rajonal në pritje edhe të samitit të Procesit të Berlinit të hënën e ardhshme, ku trajtoi nevojën e zbatimit të marrëveshjes për lëvizjen e lirë në mes të Kosovës dhe Bosnjë-Hercegovinës, e cila u kontribuon qytetarëve të dy vendeve.

Duke folur për marrëdhëniet bilaterale, kryeministri Kurti trajtoi mundësitë e bashkëpunimit edhe me emisararin e ri Alexander Kananof si dhe partnerët tanë evropianë pas zgjedhjeve të mbajtura dhe komisionarëve të rinj. Ai shtoi dhe rëndësinë e anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe bashkëpunimin e dyanshëm me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në këtë drejtim.

Përgjatë takimit u trajtua dhe dialogu me Serbinë, ku kryeministri shprehu konstruktivitetin e Kosovës në

proces dhe nevojën për zbatimin e plotë dhe sa më parë të Marrëveshjes Bazike të Brukselit dhe Aneksit Implementues të Ohrit.

Zëvendësndihmëssekretari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Alexander Kananof, është takuar edhe me liderët e opozitës. Për këtë takim ka njoftuar kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, duke bërë me dije se me Kananof kanë diskutuar për zhvillimet aktuale në Kosovë dhe rajon. "Në takim ritheksova nevojën e shtetit të Kosovës për bashkërendim të qëndrimeve me aleatët tanë strategjikë, veçanërisht me ShBA-në. Kosova, si një storie suksesi, është rezultat i bashkëpunimit të mirë dhe partneritetit të besueshëm me miqtë e saj. Zëvendësndihmëssekretarin Kananof e falënderova për mbështetjen e vazhdueshme të ShBA-së për fuqizimin shtetit tonë. Edhe e ardhmja nuk duhet të jetë ndryshe, përveçse një rrugëtim i përbashkët drejt sukseseve të reja", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, u takua me



# Pse zgjedhjet në ShBA do të vendosen nga "shtetet e luhatshme"

WASHINGTON, 11 TETOR - Me afrimin e zgjedhjeve të 5 nëntorit në ShBA, kandidatët presidencialë, Donald Trump dhe Kamala Harris, kanë bërë vizita të shumta në Pensilvani, Miçigan dhe Uiskonsin, me shpresë se do të joshin një përqindje të vogël të votuesve të pavendosur në këto shtete, të cilët mund ta kthejnë rezultatin në të mirë të tyre. Së bashku me "shtetet e tjera të luhatshme", këto tri shtete do të vendosin se kush do të bëhet presidenti i 47-të i Shteteve të Bashkuara. Në fakt, rezultati mund të vendoset nga jo më shumë se 150 000 votues nga këto shtete. Më poshtë mund të lexoni çfarë duhet të dini për shtetet e luhatshme dhe ndikimin e tyre në garën presidenciale.

## Çfarë janë shtetet e luhatshme?

"Shtetet e luhatshme" janë shtete ku gara është shumë e fortë dhe e ngushtë, dhe votat e tyre do të vendosin se kush do të bëhet presidenti i radhës i Shteteve të Bashkuara. Këtë vit ato janë: Pensilvania, Miçigani, Uiskonsini, Arizona, Nevada, Xhorxhia dhe Karolina e Veriut. Shtetet e luhatshme kanë ndryshuar me kalimin e kohës për shkak se kanë ndryshuar edhe partitë politike, çështjet dhe demografia. Pensilvania, Miçigani dhe Uiskonsini, me popullsinë e tyre të madhe të klasës punëtore kanë votuar historikisht për kandidatin demokrat. Por, që të tria ndryshuan më 2016 dhe e votuan Trumpin, i cili bëri fushatë kundër politikave të tregtisë nga të cilat, tha ai, përfitonin elita në kurriz të punëtorëve. Trumpi premtoi taksë ndaj mallrave të importuara dhe kthimin e vendeve të punës në industrinë e prodhimit. Karolina e Veriut dhe Xhorxhia, nga ana tjetër, historikisht kanë votuar për republikanët në zgjedhjet presidenciale, por garat në këto dy shtete janë bërë shumë më të ngushta vitet e fundit. Në Karolinën e Veriut ka shkuar një fluks njerëzish nga Nju-Jorku dhe



shtete të tjera që historikisht votojnë për demokratët, ndërsa në Xhorxhia ka pasur një rritje të përqindjes së njerëzve me ngjyrë dhe grupeve të tjera joshumicë. Amerikanët me ngjyrë historikisht votojnë për demokratët.

## Pse funksionon kështu?

Fenomeni i shteteve të luhatshme është rezultat i sistemit të ndërlikuar të votave elektorale në ShBA dhe faktit se në shumë shtete, e njëjta parti ka fituar në zgjedhjet presidenciale përsëri dhe përsëri, tha për Radion Evropa e Lirë (REL) David Schultz, profesor i shkencave politike në Universitetin Hamline në Minesotë. Ndryshe nga shumica e vendeve të tjera me sistem presidencial, Shtetet e Bashkuara nuk e zgjedhin liderin e tyre bazuar në rezultatin e votës popullore. Në vend të kësaj, fituesi përcaktohet nga rezultati i zgjedhjeve në secilin shtet veç e veç. "Në Shtetet e Bashkuara janë 50 palë zgjedhje të ndara në secilin nga 50 shtetet, plus Distrikti i Kolumbias, të cilat përfundimisht votojnë për presidentin e Shteteve të Bashkuara", tha Schultz, redaktor i librit të vitit 2019 "Presidential Swing States". Me disa përjashtime, secili shtet ia jep të gjitha votat e kolegjit elektorale kandidatit i cili i fiton

shumicën e votave në atë shtet. Fituesi i votës popullore në Pensilvani, për shembull, i merr 19 votat e kolegjit elektorale. Një kandidat i nevojiten 270 nga 538 votat e kolegjit elektorale për ta fituar garën për president. Secili shtet ka një numër votash të kolegjit elektorale, përafërsisht bazuar në madhësinë e popullsisë së tij. Alaska, Dakota e Veriut, Dakota e Jugut, Vermonti dhe Uaiomingu i kanë nga tri vota të kolegjit elektorale, po ashtu edhe Distrikti i Kolumbias. Katër shtetet me numrin më të madh të votave janë, Kalifornia me 54; Teksasi me 40; Florida me 30; dhe Nju-Jorku me 28. Në 38 shtete e njëjta parti ka marrë shumicën e votave në çdo palë zgjedhje presidenciale prej fillimit të këtij shekulli, shpesh duke fituar me një dallim të madh. Vetëm 12 shtete kanë "ndryshuar" të paktën një herë prej vitit 2000. Në disa shtete e njëjta parti ka fituar për një periudhë edhe më të gjatë: Votuesit në Minesotë, për shembull, ia kanë dhënë shumicën e votave të tyre kandidatit demokrat që nga viti 1976, ndërsa në Teksas republikanët kanë fituar që nga viti 1980. "Në 40 vjetët e fundit ose më shumë, shtetet janë regulluar. Disa shtete kanë më shumë demokratë që votojnë, disa shtete kanë më shumë republikanë

që votojnë. Dhe, për shkak se besnikëria ndaj partisë është kaq e fortë, ne e dinim shumë vite përpara zgjedhjeve të vitit 2024 se sa shtete do të votojnë", tha Schultz.

## Si duken gjërat këtë vit?

Harris mund të llogarisë arsyeshëm se do t'i marrë të paktën 226 vota elektorale, duke fituar shtete si Kalifornia, Illinoisi dhe Nju-Jorku, sipas "270towin.com", një uebsajt i pavarur që grumbullon sondazhe dhe projeksione profesionale për zgjedhjet. Trump pritet t'i marrë të paktën 219 vota elektorale, duke mbizotëruar në shtete si Teksasi, Florida dhe Tenesia. Kjo nënkupton se shtatë shtetet luhatëse, me 93 votat e tyre elektorale, do ta përcaktojnë rezultatin e zgjedhjeve. Kur ka mbetur më pak se një muaj deri në zgjedhje, Harris prin në katër nga shtetet luhatëse, ndërsa Trumpi në tri, sipas një analize të sondazheve nga "The Hill", një medium me bazë në Uashington. Por, marginat janë shumë të ngushta: Më pak se 1 për qind e votës ndan kandidatët në pesë shtetet e luhatshme, dhe më pak se 2 për qind në dy të tjerat, sipas sondazhit. Schultz tha se 150 000 deri në 200 000 vota nga shtatë shtetet e

luhatshme – ose rreth 0.1 për qind e të gjitha votave që pritet të hidhen – do të vendosin se kush do të hyjë në Shtëpinë e Bardhë në janar.

Kjo nuk do të ishte diçka e paparë. Një total prej 537 votash në Florida e vendosi rezultatin e zgjedhjeve presidenciale të vitit 2000, kur republikani George W. Bush e mundi demokratën Al Gore.

Megjithatë, gara e këtij viti po shkon duke u bërë më shumë si ajo e vitit 2020 sesa si ajo e vitit 2000 në lidhje me shtetet kryesore në garën zgjedhore.

Në zgjedhjet e vitit 2020, demokrati Joe Biden fitoi lehtësisht votën popullore, duke marrë rreth 80 milionë vota kundrejt 74 milionë votave të Trumpit.

Biden i fitoi Xhorxhian, Arizonën dhe Uiskonsin me një numër të përgjithshëm prej vetëm 44.000 votash. Pa këto shtete, ai do të kishte 269 vota elektorale, që nënkupton se ai do kishte numrin e ngjashëm të votave me Trumpin dhe kështu do ta kishte detyruar Kongresin të votojë për president. Kjo ka ndodhur vetëm një herë, në vitin 1800.

## Cili është çelësi i triumfit në shtetet e luhatshme?

Fituesi në shtetet e luhatshme dhe rrjedhimisht i zgjedhjeve në tërësi – shpesh përcaktohet nga vetëm disa qarqe, si Marikopa në Arizonë, Uajn në Miçigan dhe Broun në Uiskonsin. "Për mua, zgjedhjet vërtet do të vendosen nga disa votues të pavendosur në qarqet e luhatshme në disa shtete të luhatshme", tha Schultz.

Pensilvania, me 19 votat e saj elektorale, është më e rëndësishmja nga shtatë shtetet e luhatshme. Dhe qarku Lakauana, me qendër në Skranton, është fushëbeteja kryesore, tha Schultz. "Cilido që të jetë [rezultati] në Skranton, do të jetë edhe ai i zgjedhjeve presidenciale amerikane përsëri", shkroi ai në një postim në Substack muajin e kaluar. "Në vitin 2024 qarku Lakauana do të jetë përsëri qarku vendimtar që përcakton nëse Donald Trump ose Kamala Harris do të jenë president".

zëvendësndihmëssekretarin e Departamentit Amerikan të Shtetit, njëherësh i dërguari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Alexander Kasanof, të cilin e uroi për detyrën e re dhe i ofroi bashkëpunim të ngushtë të LDK-së në çështjet strategjike vitale për të dy vendet. Abdixhiku theksoi shqetësimin e LDK-së për raportin e dëmtuar të Qeverisë së Kosovës me ShBA-në si dhe me partnerët e tjerë strategjikë politikë dhe të sigurisë. Abdixhiku e siguroi Kasanofin se, me formimin e qeverisë së re, të drejtuar nga LDK-ja, pas zgjedhjeve të 9 shkurtit, riparimi i këtyre raporteve do të jetë çështje e prioritetit më të lartë. Po ashtu, ai e njoftoi Kasanofin për ecurinë e përgatitjeve për fushatën parazgjedhore, për takimet me qytetarët gjithandej Kosovës, si

dhe për shtyllat kryesore të programit politik "Rruga e re". Abdixhiku theksoi se partneriteti strategjik me ShBA-në në fushën e ekonomisë, të energjisë dhe të sigurisë është jetik për LDK-në dhe për Kosovën. Për takimin me Kasanof ka shkruar në "Facebook" edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. "Sot në ambasadën amerikane takuam zv/ndihmës sekretarin e Shtetit, Alexander Kasanof. Shfrytëzova rastin që në takim t'i falënderoj Kasanofin dhe ambasadorin Hovenier për angazhimin e tyre ndaj Kosovës. Mbështetja e fuqishme e ShBA-së ndaj popullit të Kosovës vazhdon përkundër vështirësive të panevojshme që i ka shkaktuar qeveria. E vetmja rrugë për të arritur synimet tona si shtet, është bashkëpunimi dhe partneriteti me ShBA-të, si aleati



ynë strategjik dhe i përgjithshëm", ka theksuar Haradinaj. Ndërkaq ambasadori amerikan Jeffrey M. Hovenier ka theksuar përmes një deklaratë të publikuar

në faqen e Ambasadës, se kanë mirëpritur vizitën e Kasanofit, duke theksuar mbështetjen e tyre afatgjatë për popullin e Kosovës. Në të njëjtën kohë, sipas tij, ka

adresuar shqetësimet e përbashkëta dhe ka kërkuar të arrihet përparim në rrugën evropiane të Kosovës si një shtet sovran, i pavarur dhe shumetnik.

## “Do të ndërpriten aktivitetet, ushtarët janë në rrezik të helmohen”, komandanti i FSK-së i shkruan letër Maqedonci



PRISHTINË, 11 TETOR - Komandanti i FSK-së, Bashkim Jashari, i ka shkruar letër ministrit të Mbrojtjes, Ejup Maqedonci. Në letërën e Jasharit të publikuar nga “Insajderi”, thuhet se kuzhinierët e institucioneve të tjera kanë njoftuar se nga 11 tetori nuk do të shkojnë nëpër kazerma. Komandanti ka alarmuar për rrezikun e helmimit dhe përhapjes së infeksioneve. “Të nderuar, me datën 07.10.2024 ju kam njoftuar lidhur me shqetësimet e shërbimit me ushqim për personelin e FSK dhe kam kërkuar që të merrni të gjitha masat, konform legjislacionit në fuqi, që t'i jepni një zgjidhje çështjes së ushqimit në mënyrë që FSK të vazhdojë realizimin e planifikimeve të saj. Sipas raporteve të fundit (me të cilat jeni edhe ju të njoftuar) në njësitë e FSK-së janë paraqitur shqetësime lidhur me shërbimet me ushqim, konkretisht me kuzhinierë (vonesa të ndryshme dhe ka raste kur nuk paraqiten në punë). Përveç mungesës së personelit të kuzhinave, e që ka ndikim në kualitetin e ushqimit dhe probleme të furnizimit me artikuj ushqimor, kemi edhe probleme sanitare, e kjo e fundit paraqet rrezik në helmimin dhe përhapjen

e infeksioneve tek personeli i FSK-së”, thuhet në kërkesën e tij. Sipas tij, krejt këto probleme po ndikojnë në kryerjen e detyrave. Komandant Jashari ka lënë të hapur mundësinë për pezullimin e të gjitha aktiviteteve. “Të gjitha këto probleme ndikojnë për FSK-në, në kryerjen e detyrave operacionale për përmbushje misionit, kurseve zhvillimore, stërvitjeve fushore dhe aktiviteteve tjera, konform planifikimit. Për më tepër, personeli në kuzhina të cilët janë të angazhuar nga institucionet tjera, kanë deklaruar që deri me datën 11.10.2024 do të paraqiten në punë, pastaj nuk do të paraqiten në kuzhinat e FSK-së”. Më tutje, komandanti i FSK-së foli për secilën gradë të personelit duke treguar se sa racione iu duhen të konsumojnë gjatë kohës sa janë në punë. “Bazuar në legjislacionin në fuqi ndër të tjerat shprehimisht parashihet: Personeli i FSK, rekrutët, kadetët kanë të drejtë në një (1) racion të ushqimit gjatë orarit të rregullt të punës; Pjesëtari, i cili është në shërbim/detyrë më gjatë se orari i rregullt i punës dhe koha e qëndrimit në detyrë është më shumë se dymbëdhjetë orë (12h), por jo më gjatë se

gjashtëmbëdhjetë orë (16h), ka të drejtë në dy (2) racione të ushqimit, Pjesëtari aktiv i FSK-së, i cili është në shërbim/detyrë njëzet e katër orë (24h) pa ndërprerë, ka të drejtë në tri (3) racione të ushqimit, Pjesëtari aktiv i FSK-së, i cili është në shërbim kujdestarie njëzet e katër orë (24h) dhe pjesëtari i fushës së specializuar që merr pjesë në operacione, trajnime të veçanta që kërkon aktivitet të lartë fizik kanë të drejtë edhe për ushqim shtesë”. Komandanti i FSK-së ka kërkuar nga Maqedonci dhe Dugolli që t'i jepen udhëzime se si të veprojnë më tutje, në të kundërtën duhet t'i ndërpresin të gjitha aktivitetet. “I nderuar z. ministër dhe z. sekretar, bazuar në atë që u cek më lartë ju lutem të jepen udhëzimet e duhura se si do të veprohet nga data 11.10.2024 e tutje. Pasi që, mos paraqitja e personelit nga institucionet tjera në kuzhinat e FSK-së, vonesat në furnizim me artikuj ushqimor dhe sanitar dhe rreziqet për pasojë shëndetësore do të na detyrojnë që të marrim masat për ndërprerjen e të gjitha aktiviteteve e planifikuara dhe të funksionojmë vetëm me staf esencial”, thuhet në letërën e Jasharit për Ministrinë e Mbrojtjes.



## Haxhi Shala pranë varrit të babait

PRISHTINË, 11 TETOR - Ish-deputeti i Kosovës, Haxhi Shala, ka mbërritur në Kosovë disa ditë pasi babai i tij ka ndërruar jetë. Një fotografi e publikuar nga djali i Haxhi Shalës, Edmondi, në “Facebook”, tregon mjaft shihet pranë varrit të babait. Në postimin me imazhin plot dhimbje, Edmondi ka thënë se babai i tij, Haxhiu, po mbahet padrejtësisht në burgjet e Hagës, larg familjes. “Jeta na ka vënë përballë dhimbjeve të papërshkrueshme. Sot po shkruaj për babanë tim, i cili

humbi të atin e tij, gjyshin tim të dashur, një njeri i ndershëm dhe i palodhur! Ai tani po mbahet padrejtësisht në burgjet e Hagës, larg familjes së tij, larg dashurisë së tij. Nuk ka fjalë që mund të përshkruajnë vuajtjen e një familjeje kur një njeri i pafajshëm mbahet larg për caq shumë kohë. Por ne nuk humbasim shpresën. Lutemi për drejtësi dhe për një ditë të ndriçuar, kur ai do të kthehet në mesin tonë, ashtu siç e meriton. Zemrat tona janë të thyera, por dashuria jonë për të mbetet e pathyeshme”, ka shkruar ai në “Facebook”.

## A po instrumentalizohet Policia e Kosovës nga politika?

### Reagim i KMDLNj-së

Diplomatë ndërkombëtarë hapazazi kanë shfaqur shqetësimin për instrumentalizim të Policisë së Kosovës nga politika duke theksuar specifikisht veriun e Kosovës, si shembull konkret të këtij instrumentalizimi. Në të njëjtën kohë këtë shqetësim e kanë adresuar edhe partitë opozitare dhe një pjesë e shoqërisë civile. Reagimi i institucioneve të pushtetit ka qenë rast tipik i interpretimit dhe zbatimit të standardeve të dyfishta; kur i ka konvencuar pushtetit puna e policisë, kanë lavdëruar aktivitetin e tyre ndërsa kur Policia arrestonte pjesëtarë të pushtetit apo militantë partiakë, po e njëjta polici akuzohet se: “po bënë filma për t'i dëmtuar në zgjedhjet e ardhshme.”. Rasti më eklatant i përpjekjeve për

instrumentalizim të policisë nga politika dhe pushteti aktual ndodhi në Podujevë ku mosdurimi midis pozitës LV-së dhe opozitës, LDK-së, ka arritur pikën e vlimit dhe policia është thirrur nga politika - pushteti lokal të disiplinon opozitën. Para një kohe ishte ndaluar nga policia një anëtar i LDK-së kinshe kishte shqetësuar dhe kanosur kryetarin e komunës, Shpejtim Bulliqin, anëtar i LV-së. Pastaj ishte denoncuar një anëtar i LV-së sepse paska sulmuar një të LDK-së. Dhe nuk përfundoi me kaq. Valon Demolli, asamblist i LDK-së në kuvendin komunal të Podujevës e që është edhe Shef i Grupit të Këshilltarëve të LDK-së u ftua në stacionin policor në Podujevë për të dhënë një deklaratë për një aktivitet krejtësisht në përputhje me mandatin dhe detyrimet që i ka si asamblist i zgjedhur me votën e qytetarit. Në fshatin Buricë kishte



informata se një kohë të gjatë mungonte uji për pije dhe higjienë e që shkaktonte shumë probleme për nxënës dhe arsimtarë sikur që kushtet ishin të rënda për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Në kuadër të mandatit dhe detyrimit si asamblist i zgjedhur, Valon Demolli, bashkë me asamblistë të kësaj partie vizituan shkollën fillore në fshatin Buricë të Podujevës për të adresuar shqetësimet e prindërve për kushtet e rënda për nxënës dhe personelin duke postuar një video për këtë vizitë. Pas kësaj, asamblisti Demolli që ka një aktivitet të

intensifikuar prej opozitari u ftua nga policia e Kosovës për të dhënë deklaratë, duket sipas kërkesës së DKA të komunës së Podujevës (sipas komunikatës për media të asamblistit Valon Demolli). KMDLNj ka informata se Policia e Kosovës ftohet shpesh në takime të natyrës jopolicore duke krijuar përshlyetje se situatat janë buzë përshkallëzimit për faktin se pozita qenka rrezikuar nga opozita. Është fshehtësi publike se në komunën e Podujevës në mënyrë diskrete apo haptas mbahen shënime dhe përcillen vizitorët apo ata që kanë nevojë për shërbime komunale. KMDLNj ia kujton policisë se asamblistët kanë imunitet dhe nuk mund të pengohen në punë që është në kuadër të mandatit dhe përgjegjësi që i kanë prandaj kundërshton çdo përpjekje për instrumentalizim të policisë nga politika pavarësisht

nivelit të përfaqësimit. Valon Demolli dhe asamblistë tjerë, pavarësisht nga përkatësia partiake nuk duhet të pengohen në përmbushjen e mandatit dhe detyrimit ndaj qytetarit. Vizita e asamblistit Demolli në shkollën në Buricë paraqet interes për publikun sepse adreson mangësitë dhe problemet me të cilat përballen nxënësit, prindërit dhe arsimtarët duke kërkuar zgjidhje. DKA dhe autoritetet komunale në Podujevë duhet të jenë përkrahës të aktiviteteve të tilla sepse janë adresa e përgjegjësisë sikur edhe mundësia për zgjidhje të problemeve të adresuara. Këto shqetësime të drejta të asamblistëve janë në funksion të realizimit dhe përparimit të drejtave të njeriut sikur që çdo veprim për instrumentalizim të policisë së Kosovës është në kundërshtim të plotë me te drejtat e njeriut.

## Aliu: Katër komnat veriore janë pjesë e AKK-së

PRISHTINË, 11 TETOR - Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Agim Aliu, tha se katër komnat e pjesës veriore të Kosovës janë pjesë e Asociacionit të Komunave të Kosovës. Aliu në "Facebook" ka bërë me dije se tre prej tyre janë pjesë qysh më herët e, së fundmi, pjesë e saj është edhe komuna e Mitrovicës së Veriut, ku paguajnë

anëtarësinë në AKK. Sipas tij, çdo përpjekje për ta mohuar e shtrembëruar këtë fakt paraqet propagandë, shpifje të ulët, që nuk i kontribuon asgjë interesit të qytetarëve. "Për hir të informimit të drejtë të qytetarëve, si kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës, njoftoj se katër komnat veriore janë pjesë e Asociacionit të Komunave të

Kosovës, tre prej tyre janë pjesë qysh më herët e së fundmi, pjesë e saj është edhe Komuna e Mitrovicës së Veriut, ku paguajnë gjithashtu anëtarësinë në AKK, andaj çdo përpjekje për ta mohuar e shtrembëruar këtë fakt, paraqet propagandë, shpifje të ulët, që nuk i kontribuon asgjë interesit të qytetarëve", ka shkruar Aliu.



## Lajçaku dhe Bislimi po bashkëpunojnë për takimin e radhës

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 TETOR - I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun, Miroslav Lajçak, tha të enjten vonë se është takuar me kryenegociatorin e Kosovës, Besnik Bislimi, në Vjenë, për ta përgatitur takimin e radhës të kryenegociatorëve në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Kisha takim të mirë dhe të dobishëm me zëvendëskryeministrin e parë Besnik Bislimi. Biseduam hollësisht për zbatimin e plotë të marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit", shkroi ai. Megjithatë, ai nuk tregoi se kur do të mbahet takimi i ardhshëm i kryenegociatorit të Kosovës dhe të Serbisë ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian në Bruksel. Bislimi dhe kryenegociatori i Serbisë, Petar Petkoviç, ishin në Bruksel për herë të fundit më 20

shtator, por nuk u pajtuan për takim të përbashkët. Ata zhvilluan dy herë bisedime të ndara me Lajçakun, i cili duket se nuk arriti t'i bindë ata për një takim trepalësh. Ata e akuzuan njëri-tjetrit për dështimin e takimit trepalësh. Bislimi tha se Serbia e "kushtëzoi agjendën e takimit me kërkesa të papranueshme për Kosovën", kurse Petkoviç i akuzoi Bislimin se nuk pranoi trepalësh për shkak të insistimit të palës serbe për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Temë kryesore e takimeve të fundit ka qenë zbatimin e Marrëveshjes Bazë dhe aneksit të implementimit në Ohër, për të cilat Kosova dhe Serbia janë pajtuar më 2023, por nuk kanë bërë hapa për zbatimin e saj. Marrëveshja e Ohrit, prej 11 nenesh, parashihet një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë, njohje të ndërsjellë



të simboleve shtetërore, që Serbia të mos bllokojë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, dhe kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë

dialogut. Kosova dhe Serbia bëjnë dialog nën ndërmjetësimin e BE-së për normalizimin e marrëdhënieve qysh nga viti 2011. Përveçse në nivel kryenegociatorësh, bisedimet

zhvillohen edhe në nivel politik. Megjithatë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, nuk janë takuar qysh nga shtatori i vitit 2023 dhe të dy e kanë akuzuar njëri-tjetrin për qasje jokonstruktive.

## Deputetja e LV-së i bashkohet LDK-së



PRISHTINË, 11 TETOR - Deputetja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Drita Millaku, nga e premija është pjesë e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se Millaku po i bashkohet familjes politike në rrugëtimin e përbashkët që i pret. "Ky vendim i saj për të qenë pjesë e radhëve tona është jo vetëm një dëshmi e përkushtimit të saj politik, por gjithashtu një tregues i qartë se vizioni dhe programin i LDK-së për Republikën, është i duhuri sot", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook". Ai ka thënë se "Millaku është një figurë e respektuar në Prizren dhe një deputete e mandatuar dy herë. Ajo vjen si aset i rëndësishëm

partiak dhe si kuadër për programin politik të LDK-së dhe të ardhmen e vendit tonë". "Me Dritën kemi diskutuar gjatë për vizionin tonë të përbashkët për Republikën; për arsimin në veçanti, për programin tonë politik dhe të ardhmen e vendit tonë. Drita ka një pasion për librin, por edhe për të krijuar mundësi për të rinjtë dhe gratë në Kosovë. Ajo e kupton rëndësinë e bashkëpunimit dhe e sheh ndërtimin e një rrugëtimi të përbashkët si një mënyrë për të realizuar ndryshime të qëndrueshme, ato që sot LDK po i ofron. Besimi i saj në potencialin e Kosovës, së bashku me përkushtimin e saj për arsim janë motive që e bëjnë Dritën tejet të rëndësishme në këtë proces", ka thënë Abdixhiku.

## Enrico Barduani, komandant i ri i KFOR-it

PRISHTINË, 11 TETOR - Gjeneralmajori i ushtrisë italiane, Enrico Barduani, e ka marrë të premten edhe zyrtarisht detyrën e shefit të misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR. Barduani është përshkruar si njohës i mirë i rajonit të

Ballkanit. Këtë pozitë për një vjet e ka pasur gjeneralmajori i ushtrisë turke Ozkan Ulutash. Ulutash ka përmendur që KFOR-i përkrah plotësisht dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë si platformën e vetme për zgjidhje të të gjitha

mospajtimeve mes dy palëve. Ai është nderuar me medalje për përkushtimin e tij në këtë dhe në misionet e tjera të NATO-s. Krerët më të lartë të shtetit kanë marrë pjesë në këtë ceremoni, përfshirë presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti.



# Guvernatori Ismaili: Lufta kundër financimit të paligjshëm kërkon një përpjekje gjithëpërfshirëse

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 TETOR - Identifikimi dhe zbutja e rreziqeve të pastrimit të parave kërkon qasje gjithëpërfshirëse ku kombinohen kapacitetet e avancuara teknologjike, pajtueshmëria rregullatore si dhe bashkëpunimi midis sektorit publik dhe privat. Kështu ka theksuar guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, në panelin me temë “Rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe partneritet publiko-privat për t’i trajtuar financat e paligjshme” me rastin e lansimit të Rrjetit të Përbashkët të Inteligjencës kundër Pastrimit të Parave në Republikën e Kosovës (JMLIN-K). Guvernatori Ismaili gjatë këtij paneli ka potencuar se pastrimi i parave nuk prek vetëm institucionet financiare

individuale, por paraqet rrezik më të gjerë për stabilitetin dhe integritetin e sistemit financiar. Ai ka shtuar se luftimi efektiv ndaj tij është thelbësor për ruajtjen e besimit dhe sigurimin e stabilitetit ekonomik të vendit. Sipas guvernatorit Ismaili, lufta kundër financimit të paligjshëm, duke përfshirë pastrimin e parave, financimin e terrorizmit si dhe format e tjera të krimit financiar, kërkon përpjekje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar ku bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit përmes partneriteteve publiko-privat është vendimtar për ruajtjen e sigurisë dhe integritetit të sistemit financiar. “Kompleksiteti në rritje dhe sofistikimi i krimeve financiare i nxitur edhe nga zhvillimet e hovshme teknologjike kërkon qasje të reja të bazuara në rrezik për parandalimin dhe luftimin e PP/FT. Prandaj një

partneritet i fortë i tillë ofron një kornizë gjithëpërfshirëse ku organet e zbatimit të ligjit, rregullatorët dhe institucionet financiare mund t’i ndajnë informacionet, ekspertizën si dhe burimet në luftën e përbashkët”, ka potencuar guvernatori Ismaili. I pari i BQK-së theksoi se krijimi i këtij rrjeti do t’i rrisë fuqishëm shanset e vendit tonë për t’u bashkuar organizatave ndërkombëtare si MONEYVAL dhe Task Forca e Veprimit Financiar (FATF), si pjesë e rëndësishme e proceseve tona integruese në institucionet dhe mekanizmat e Bashkimit Evropian. Guvernatori Ismaili ka shtuar se përmes themelimit të këtij mekanizmi do të realizohen procese të rëndësishme në aspekt të sigurimit të pajtueshmërisë me standardet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit. Këto aspekte, përveç avancimit të

kornizës ligjore dhe rregullative që BQK-ja ka realizuar dhe po vazhdon në proces, bashkë me ligjet që së fundi janë proceduar, patjetër që e përafroi vendin tonë me kërkesat relevante të Bashkimit Evropian. Madje kjo do ta ndihmojë edhe procesin e paraaplikimit për anëtarësim në SEPA si një ndër prioritetet tona, në të cilat BQK po punon me mbështetjen ndërinstitucionale. Në fund të fjalës së tij në panel, guvernatori Ismaili u shpreh se identifikimi efektiv dhe zbutja e rreziqeve të pastrimit të parave kërkon një qasje dinamike, me shumë shtresa që integron teknologjinë, pajtueshmërinë, bashkëpunimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm. Ai ka pohuar se BQK-ja me instrumentet e saj rregullatore dhe veprimet e ndërmarra të fokusuar në aspekt të integritetit dhe stabilitetit të sektorit

financiar ka dëshmuar edhe praktikisht këtë zotim dhe qasje të saj. “Duke miratuar strategji të bazuara në rrezik, duke përdorur analitikë të avancuar dhe duke nxitur partneritete të forta, institucionet financiare dhe rregullatorët e Kosovës mund të ndërtojnë një mbrojtje të fortë kundër pastrimit të parave dhe të ndihmojnë në mbrojtjen e integritetit të sistemit financiar”, ka përfunduar guvernatori Ismaili. Rrjeti i Përbashkët të Inteligjencës kundër Pastrimit të Parave në Kosovë përbëhet nga autoritetet ligjzbatuese të vendit, mbështetur nga Njësia për Inteligjencë Financiare dhe Ambasada e Britanisë së Madhe në Kosovë, ku edhe BQK ka pasur kontributin e saj përmes ekipeve profesionale dhe do të vazhdojë të mbetet e përkushtuar dhe angazhuar në të.



## Ministri Peci merr pjesë në hapjen e Panairit të Produkteve Tradicionale dhe Artizanale në Podujevë

PRISHTINË, 11 TETOR - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka marrë pjesë në hapjen e Panairit të Produkteve Tradicionale dhe Artizanale në Podujevë, me ç’rast është shoqëruar edhe nga kryetari i kësaj komune, Shpejtim Bulliqi dhe profesori Rexhep Gjergji.

Ky panair, i cili është mbështetur nga MBPZHR-ja, sipas ministrit Peci, është një përpjekje për t’i mbajtur

gjallë dhe për promovuar vlerat tona të jashtëzakonshme. “Për tri ditë me radhë bulevardit i qytetit të Podujevës do të shndërrohet në një skenë unike, ku tradita dhe trashëgimia jonë e pasur do të shfaqen në çdo cep. Në këtë panair do të mund të gjeni produkte ushqimore tradicionale që mbartin me vete shijen e autoktonisë sonë dhe punime artizanale me një mjeshtëri të rrallë, të krijuara me dashuri nga duart e grave

punëtore të Llapit”, ka thënë ministri Peci.

Ndër të tjera, ai ka theksuar se synojnë t’i mbështesin prodhuesit vendorë dhe ta vënë në pah rëndësinë e ruajtjes së traditës, duke krijuar një hapësirë ku historia jonë të përjetohet përmes shijes, artit dhe kulturës.

Panairi i Produkteve Tradicionale dhe Artizanale në Podujevë do të jetë i hapur tri ditë me radhë.





# Ismail Bej Qemali në Kongresin e Xhonturqve në vitin 1902 në Paris

Nga: Evarist BEQIRI

Në fillim të shkurtit 1902, u mbledh në Paris, Kongresi i Parë i Xhonturqve ose thënë ndryshe Kongresi i Opozitës Liberale Osmane. Fotografia që po sjellim është botuar në një nga revistat e përjavshme italiane më të lexuara të kohës "L'illustrazione italiana", më 15 shkurt 1902. Në qendër të fotografisë gjendet princi i kurorës Sabahaddin (Sabahedin) dhe në të djathtë të tij gjendet Ismail Qemal Bej Vlorë.

Njëkohësisht po publikojmë për herë të parë artikullin për Kongresin otoman, të publikuar nga gazeta franceze "Le Bloc", i shkruar nga Xhorxh Klemanso (Georges Benjamin Clemenceau, 1841-1929), më 22 shkurt 1902. Aty pasqyrohet edhe zgjedhja e Ismail Qemalit në Komitetin e Përhershëm. Kjo gazetë përgatitej dhe botohej asokohe nga Xhorxh Klemanso, burrshtetas francez, mjek dhe gazetar, i cili më pas do të bëhej ministër dhe kryeministër i Francës. Ai ishte një nga politikanët më të rëndësishëm francez të Republikës së Tretë.

Ismail Qemali kishte kultivuar një miqësi të hershme me shkrimtarin e madh francez Viktor Hygo dhe politikanin Xhorxh Klemanson, këtë fakt të rrëfyer nga goja e Ismail Qemalit, e dëshmon liriku i madh Ali Asllani, në kujtimet e tij. Ishte viti 1871, kur francezët protestonin për çështjen e Alsas-Lorenës, Ismail Qemali u ftua dhe u shoqërua nga Viktor Hygo dhe Xhorxh Klemanso në Paris, ku mori pjesë edhe në një seancë plenare të parlamentit francez.

Ismail Qemali kishte spikatur në qarqet intelektuale turke edhe në ato evropiane si përkrahës i parimeve liberale. Ai përkrahte parimin e decentralizimit të Perandorisë Osmane, respektimin e të drejtave kombëtare dhe rivendosjen e kushtetutës osmane. Ismail Qemal Vlorë ishte një figurë kyçe si e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare ashtu edhe e Revolucionit të Turqve të Rinj. Ismail Qemali, së bashku me eksponentë të tjerë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare si Ibrahim Temo, Dervish Hima, Jashar Erebara etj., u përfshinë në lëvizjen e Turqve të Rinj (Xhonturqve), duke pasur parasysh synimin e kësaj lëvizjeje për rivendosjen e kushtetutës së vitit 1876. Ata e shikonin atë si një mundësi për të realizuar të drejtat kombëtare shqiptare. Por, për shkak se Ismail Qemali i mbeti besnik vizionit dhe ideve të tij, ai u nda me Turqit e Rinj që në kongresin e zhvilluar në Paris

më 1902, pavarësisht se ai ishte edhe një prej organizatorëve të tij.

Ismail Qemali pas arratisjes së tij të bujshme nga Kostandinopoja më 1 maj 1900, vazhdonte të banonte në Bruksel, ndërkohë dy djemtë e Damat Mahmudit – princi Sabahedin dhe princi Lutfullah nga familja perandorake osmane – u kthyen nga Egjipti dhe u ngulën me banim në Paris, ku dhe po bënin plane për të thirrur një kongres për të diskutuar situatën në Turqi. Ata shkuan në Bruksel, ku e takuan dhe e ftuan edhe Ismail Qemalin që të merrte pjesë në këtë kongres të liberalëve osmanë, që ishin në azil nëpër Europë.

Ismail Qemali vendosi si kusht kryesor për pjesëmarrjen e tij në këtë kongres, që aty të përfaqësoheshin të gjitha etnitë e Perandorisë, në mënyrë që të formuloheshin dëshirat e të gjithë popujve. Kushtet e tij u pranuan dhe ai shkoi në Paris, ku u mbajt kongresi. Pas debatesh të gjata e të nxehta, shumica e Kongresit të Turqve të Rinj, e kryesuar nga princi Sabahedin dhe e përkrahur nga Ismail Qemali, dha pëlqimin t'u drejtohej një thirrje Fuqive për një regjim në përputhje me parimet e Kushtetutës së 1876. Ky organizim duhet të përfshinte të gjithë elementët etnikë në Turqi, duke u garantuar liri e drejtësi dhe mbrojtje të të drejtave kombëtare të tyre. Por, një ndarje e thellë u shënuar lidhur me çështjen e ndërhyrjes së huaj. Grupi, i kryesuar nga filozofi Ahmed Riza, i cili këmbëngulte për një pushtet qendror të fortë, e kundërshtonte me forcë çfarëdolloj ndërhyrje të jashtme. Kështu që midis Turqve të Rinj filluan të merrnin formë dy rryma kryesore, njëra që favorizonte nacionalizmin turk dhe tjetra otomanizmin liberal.

Turqit e rinj përkrahnin idenë e pushtetit të qendëruar, ndërsa kombësitë joturke si shqiptarët dhe armenët ishin për decentralizimin e pushtetit. Ideja që përkrahte Ismail Qemali ishte dhënia e autonomisë për kombësitë joturke në perandori. Ismail Qemali mori pjesë në kongresin e xhonturqve si shqiptar dhe ai kurrë nuk u bë xhonturk. Parulla e Ismail Qemalit ishte: "As me turqit e vjetër as me turqit e rinj, por të punojmë për vatanin". Ismail Qemali ka bashkëpunuar me xhonturqit vetëm kur kjo ishte në interes të çështjes shqiptare. Ai kishte rezervat e veta ndaj krerëve xhonturq, ashtu si edhe krerët xhonturq kishin rezervat e tyre ndaj Ismail Qemalit.

Megjithatë, xhonturqit kishin nevojë për burra shteti dhe njerëz të kalibrit të Ismail Qemal



Vlorës. Ata i propozuan atij kryesimin e organit të tyre më prestigjioz të shtypit, gazetës "Osmanllë". Ai nuk e pranoi propozimin, për arsye se, siç thoshin xhonturqit, "Ismail Qemali përpara çdo gjëje mendon për Shqipërinë.". Sejfi Vllamasi, në librin "Ballafaqime politike", shkruan se: "Ismail Qemali, i shquar si diplomat e patriot shqiptar, dhe me një prestigj të konsiderueshëm në Shqipëri e në Turqi dhe jashtë kufijve të perandorisë, peshonte rëndë. Për këtë shkak, xhonturqit e urrenin dhe ia kishin frikën".

Ismail Qemali e shikonte bashkëpunimin me Turqit e Rinj si pjesë e luftës së përbashkët të shqiptarëve dhe turqve për vendosjen e rendit kushtetues në Perandorinë Osmane. Por, nga ana tjetër, ai kërkonte të ruante pavarësinë e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare nga lëvizja xhonturke. Ai nuk dëshironte që shqiptarët të identifikoheshin si turq, osmanë apo myslimanë. Siç do të tregonin më pas faktet, politika dritëshkurtër dhe nacionaliste e xhonturqve, vuri në rrezik jo vetëm ekzistencën e popullit shqiptar, por edhe vetë ekzistencën e pavarur të kombit turk, i cili shpëtoi vetëm falë revolucionit të udhëhequr nga Mustafa Qemali.

Ismail Qemali e shikonte vijimin e bashkëpunimit midis turqve dhe shqiptarëve në luftën e përbashkët për ta futur Turqinë në rrugën e reformimit dhe njohjes së të drejtave kombëtare dhe autonomisë për popujt brenda Perandorisë, duke u dhënë atyre autonomi sa më të gjerë në përputhje me nenin 23 të Traktatit të Berlinit. Largpamësia politike e Ismail Qemalit shfaqet edhe në letrën e datës 18 tetor 1900, nga Brukseli, ku pasqyrohen mendimet e shprehura nga Ismail Qemali lidhur me të ardhmen e Perandorisë Osmane. Pavarësisht verbërisë

proverbiale të xhonturqve, Ismail Qemali e kishte kuptuar që herët rrezikun që u kanosej shqiptarëve nga shpërbërja e Perandorisë Osmane. Nuk do të kalonte asnjë dekadë dhe parashikimet e Ismail Qemalit do të bëheshin realitet.

Ismail Qemali ishte një shqiptar, i cili i përkiste fesë myslimane. Si mysliman dhe anëtar i Perandorisë, ai ishte për ruajtjen e Perandorisë Osmane. Por njëkohësisht si shqiptar, ai mbështeste një qeverisje të decentralizuar, e cila do të bënte të mundur autonominë e Shqipërisë. Në grupin e xhonturqve të Ahmed Riza, ai shikonte jo vetëm tendencën për një qeverisje të centralizuar, por edhe dëshirën për dominim të elementëve turq në Perandori. Ismail Qemali përkrahte grupin e princit Sabahedin, pasi aty shikonte mundësinë për të fituar më shumë të drejta dhe liri për shqiptarët si grup etnik. Në këtë periudhë, aktiviteti i Ismail Qemalit fokusohet njëkohësisht te rrëzimi i sulltan Abdyl Hamidit II dhe në lëvizjen kombëtare shqiptare, e cila ishte duke fituar terren gradualisht. Prandaj, ai hartoi edhe një projekt për fillimin e një revolucioni kundër sulltanit nga provinca e Tripolitanisë. Ismail Qemali përkrahte decentralizimin e thellë të Perandorisë Osmane, dhe sigurimin e të drejtave të barabarta për të gjithë nënshtetasit pa dallim kombësie dhe feje. Ismail Qemali ishte mburjtur me konceptet liberale, prandaj e shikonte të ndërlydhur zhvillimin ekonomik të vendit me depërtimin e kapitalit të huaj. Në lëvizjen kombëtare shqiptare ai përkrahu fillimisht autonominë kulturore dhe më pas autonominë politike dhe administrative nën Perandorinë Osmane. Këtë stad Ismail Qemali e shikonte të nevojshëm për mbrojtjen dhe konsolidimin e shtetit të ri dhe si pararendës të formimit të shtetit

të pavarur shqiptar.

Qemali mendonte se krijimi i një shteti shqiptar të fuqishëm do të pengonte shtrirjen e mëtejshme të sllavizmit në Ballkan dhe afrimin e Ruisë në Mesdhe. Kjo doktrinë qëndronte në themel të programit politik të Ismail Qemalit dhe po ky koncept qëndron edhe sot në themelet e aleancave strategjike të shtetit shqiptar. Ismail Qemali i drejtoi sytë e shqiptarëve nga Perëndimi. Ai nuk bënte pjesë në grupin e atyre që i kishin sytë nga Lindja dhe ndiheshin më tepër myslimanë dhe turq, sesa ndiheshin shqiptarë. Ai bënte pjesë në grupin e atyre shqiptarëve që e vendosnin kombin mbi fenë dhe mundësuan krijimin e kombit shqiptar mbi tri fe të ndryshme. Ismail Qemal Vlorë u përpoq që ta përmirësonte Perandorinë Osmane, së cilës i shërbeu me zell dhe i kushtoi një pjesë të mirë të jetës së tij.

Në fund, Ismail Qemal Vlorë veprimi njësoj si baballarët e kombit dhe hartuesit e Deklaratës së Pavarësisë amerikane në vitin 1776, të cilët pavarësisht se i kishin shërbyer Perandorisë Britanike, në fund e luftuan shtypjen e padrejtë dhe e udhëhoqën kombin e tyre drejt lirisë dhe pavarësisë. Thomas Jefferson deklaronte se: "Nuk ka njeri në Perandorinë Britanike që ta dojë më shumë se unë bashkëjetesën me Britaninë e Madhe. Por, në emër të Zotit që më ka bërë, më mirë vdes sesa ta lejoj këtë bashkim me ato kushte që propozon Parlamenti Britanik; dhe në këtë rast mendoj se përfaqësoj ndjenjat e Amerikës.". Një ide e ngjashme do të vërtitej edhe në mendjen e Ismail Qemalit, për raportet turko-shqiptare, 136-vite më pas kur ai shpalli Pavarësinë e Shqipërisë në Vlorë. /Gazeta "Panorama"/

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Prishtina - Kastrioti, ndeshja kryesore në Superligën e hendbollit

**PRISHTINË, 11 TETOR** - Me ndeshjen Prishtina - Kastrioti mbyllet xhiroja e pestë e Superligës së Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve. Ndeshja që zhvillohet të hënën nga ora 20:00 është më interesante e javës. Të dyja skuadrat i kanë nga katër pikë dhe

do të kërkojnë fitore për të mbetur në hap me Rahovecin e Besën. Xhiroja fillon me ndeshjen Besa Fungas - Vjosa, që zhvillohet të shtunën nga ora 13:00 në Pejë. Besa është favorite e madhe. Po të shtunën, prej orës 19:00, Rahoveci e pret Trepçën që po kalon çaste të vështirë.

“Vrështarët” llogarisin në dy pikë të reja. Të dielën është takimi Llapi - Vushtrria, që nis në ora 17:00. Edhe në këtë ndeshje pritet rivalitetet dhe hendboll i mirë. Cilësia e skuadrave vlerësohet e përafërt, kështu që ndeshja pritet të jetë e hapur deri në fund.

Në Ligën e Parë të hendbollistëve është java e tretë. Të shtunën janë ndeshjet Samadrexha - Drenica (18:00) dhe Drita - Istogu (16:30), ndërkohë që dielën prej orës 14:30 në Shtime takohen Ulpiana e Vëllaznimi, ndërsa të hënën prej orës 18:30 është ndeshja Prizreni - Deçani.



## Foda dhe Rrahmani: Ndaj Lituanisë luajmë për fitore

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 11 TETOR** - Fitorja është synim i Kosovës në ndeshjen e Ligës së Kombeve ndaj Lituanisë, e cila zhvillohet sot (e shtunë) në Kaunas nga ora 15:00. Kështu kanë bërë me dije përzgjedhësi Franco Foda dhe kapiteni Amir Rrahmani në konferencë për medie një ditë para ndeshjes. Strategu gjerman që është në krye të “dardanëve”, ka thënë se do të jetë ndeshje e vështirë, por Kosova synon ta fitojë grupin dhe në secilën ndeshje duhet të luajë për fitore. “Litania është një ekip bukur i mirë. Do të jetë një ndeshje e vështirë, por ne kemi ardhur të fitojmë. Duhet të jemi kompakt në mbrojtje dhe ta bëjmë lojën tonë. Nëse duam ta fitojmë grupin, duhet ta fitojmë secilën ndeshje. Është përballje shumë e rëndësishme”, ka thënë Foda, i cili më pas ka lavdëruar

edhe kundërshtaren e sotëm, Lituaninë. “Litania ka pasur performanca të mira pavarësisht prej rezultateve jo të dëshiruara. I kemi parë dhe analizuar të gjitha ndeshjet e saj, sidomos ndeshjen me Rumaninë, ku ka treguar paraqitje shumë të mirë. Po futbollit është i tillë”, ka shtuar Foda. “Dellova dhe Aliti kanë zhvilluar paraqitje të mirë në ndeshjen e fundit, kështu që kemi disa opsione të mira për nesër. Aliti, Dellova, Krasniqi dhe Hoti janë opsionet për të cilat do të vendosë pas stërvitjes”, ka përfunduar Foda. Në konferencë për medie i pranishëm ishte edhe kapiteni i Kosovës, Amir Rrahmani. Ashtu si përzgjedhësi Foda edhe futbollisti i Napolit ka shprehur optimizëm për ndeshjen e radhës, duke thënë se “dardanët” zbresin në fushën e stadiumit “Darius and Girėnas Stadium” vetëm për fitore. “Jemi përgatitur shumë mirë për këtë



ndeshje, sepse Litania është një ekip që luan futboll të mirë dhe ka posedim të topit. Duhet të shfrytëzojmë çdo moment. Do të zbresim nesër në fushë për fitore. Rezultatet e Lituanisë nuk e kanë

pasqyruar realitetin e performancës së tyre në fushë, sepse në dy ndeshjet kanë luajtur lojë shumë të mirë. Ndeshjen me Qipron e kanë dominuar totalisht”, ka thënë Rrahmani.

Kosova në dy ndeshjet e para ka grumbulluar tri pikë, kurse ndeshjen e dytë të këtij muaji në Ligën e Kombeve e zhvillon të martën në stadiumin “Fadil Vokrri” kundër Qipros.

## Derbi i rivalëve të vjetër në Prishtinë



**PRISHTINË, 11 TETOR** - Java e pestë në ProCredit Superligën e Kosovës në basketboll do të dhurojë sfida mjaft interesante. Ndeshja e parë e kësaj xhiroje është në mes të rivalëve të vjetër në basketbollin e Kosovës, Sigal Prishtinës dhe Pejës. Bardhekaltrit kanë tri fitore dhe një humbje në katër xhirot e para, derisa pejanët dy fitore dhe dy humbje. Dy skuadrat me traditë dhe shumë trofe, synojnë fitoren në këtë përballje. Takim shumë i

rëndësishëm është në mes të Borës dhe Vëllaznimit. Prishtinasit kanë katër humbje në këtë edicion dhe janë në kërkim të fitores së parë në elitë, kurse kuqezinjët kanë dy fitore e dy humbje. Takim, po ashtu, shumë interesant është ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Bashkimit. Therandasit kanë dy fitore e dy humbje, ndërsa prizrenasit janë skuadra e vetme pa humbje, katër fitore në katër ndeshje. Xhiroja e pestë përmbillet me ndeshjen

ndërmjet Proton Cable Prizrenit dhe Trepçës. Prizrenasit kanë një fitore e tri humbje, kurse mitrovicasit dy fitore dhe dy humbje.

### PROCREDIT SUPERLIGA - JAVA 5

**Të shtunën takohen:**  
17:00 Sigal Prishtina - Peja  
19:00 Bora - Vëllaznimi

**Të dielën takohen:**  
17:00 Golden Eagle Ylli - Bashkimi  
19:00 Proton Cable Prizreni - Trepça

## Daniel Nelson emërohet trajner i ri i Pejës

Pejë, 11 tetor - KB Peja e ka emëruar Daniel Nelson në pozitën e trajnerit. Irlandezi e zëvendëson në krye të skuadrës pejane Rami Hadar, i cili ditë më parë u largua nga ky klub. Trajneri që ka punuar edhe në Gjermani, Rusi, Angli

e shumë vende të tjera, debutimin në krye të Pejës e bën të shtunën në përballje me Sigal Prishtinën. “Irlandezi Daniel Nelson është emëruar trajner i ri i KB Peja dhe do ta marrë drejtimin e ekipit nga sot,

duke qenë kështu kryetrajner i skuadrës që nga ndeshja me Sigal Prishtinën që luhet të shtunën në orën 17:00. 40-vjeçari vjen në Pejë pas eksperiencave të ndryshme në Gjermani, Rusi, Angli, Irlandë, Zelandë të Re, Qipro,

Rumani, shkurt në Kosovë dhe së fundmi edhe në Holandë. Një pjesë e madhe e sezonit na pret dhe së bashku me Nelson do të luftojmë për përmbushjen e objektivave të KB Pejës. Na priftë e mbara!”, thuhet në njoftimin e KB Peja.



## Messi ankohet pas barazimit ndaj Venezuelës: Kushtet ishin skandaloze

**BUENOS AIRES, 11 TETOR** - Lionel Messi është i lumtur për kthimin në kombëtaren e Argentinës, pas dëmtimit, por jo aq për barazimin 1-1 ndaj Venezuelës. Kapiteni i Argentinës e komentoi kështu ndeshjen në transfertë, e vlefshme për kualifikueset e Amerikës së

Jugut, me synim sigurimin e biletave finale të Botërorit 2026: “Ishte një pritje e gjatë për të luajtur përsëri. Kishte kaluar një kohë e gjatë pa luajtur me kombëtaren. Më kishte munguar kjo fanellë. Natyrisht ndihem i lumtur që jam kthyer, që jam në gjendje të jem sërish

këtu”. “Nëse themi të vërtetën, është bërë shumë e vështirë të luash këtu, në të tilla kushte. Grumbullimi nuk na ndihmoi të bënim atë që donim. Nuk ishim të përgatitur për një ndeshje të tillë. U zëmë në befasi për të luajtur me topat e dytë dhe shfrytëzuar gabimet e

kundërshtarit. Nuk ia dolëm dot të bënim dy pasime radhazi për shkak të kushteve skandaloze të fushës. Jam i lumtur të luaj sërish në Argentinë të martën. Tani do të udhëtojmë, do të pushojmë dhe do të përgatitemi për ndeshjen në shtëpi”, ka deklaruar Messi.



## Cannavaro zbulon prapaskenën e ‘Topit të Artë’: Mendoja se ishte shaka

Romë, 11 tetor - Legjenda e Italisë, Fabio Cannavaro zbulon, se një gazetar i “France Football” e endoqi atë në shtëpi pas një seance stërvitore te Real Madridi për ta informuar se ai kishte fituar “Topin e Artë”: “Mendoja se po tallej me mua”. Cannavaro fitoi “Topin e Artë” në vitin 2006, disa muaj pasi udhëhoqi Italinë drejt fitimit të Kupës së Botës. Ish-mbrojtësi kaloi te Real Madridi nga Juventus pas skandalit nga Juventusi pas skandalit nga Calcio e atë verë dhe fitoi çmimin më të rëndësishëm individual për futbollistët disa muaj më vonë. “Një gazetar i ‘France Football’ erdhi në Valdebebas në Madrid. Isha në makinë time dhe dëgjoja dikë duke bërë ‘Fabio, Fabio’, ka thënë ish-mbrojtësi për “Gazzetta dello Sport”. “Ndalova makinën. Ai ishte pa frymë dhe filloi të fliste me mua. Më tha: ‘Duhet të flas me ty. Unë punoj për ‘France Football’ dhe më dha kartën e tij të biznesit. Unë i thashë: ‘Po shkoj në shtëpi’ dhe ai më pyeti: ‘A mund të vij me



ju? Më duhet të flas me ju për një gjë të rëndësishme në lidhje me ‘Topin e Artë’. Ai hyri në makinë dhe tha: ‘Shiko, e di që ka kaq shumë kohë para ceremonisë, por nga votat, doli që ju e keni fituar ‘Topin e Artë’. Mendoja se po bënte shaka me mua”, kujton Cannavaro. “I telefonova gruas sime dhe thashë se po kthehesha në shtëpi me një mik i cili më

thotë se do ta fitoj ‘Topin e Artë’. Ajo tha: ‘Shiko, Fabio, mendoj se është një shaka’. Ishte qesharake dhe e papritur. E dija që Kupa e Botës ishte fantastike, por për një mbrojtës ta fitoj ‘Topin e Artë’ është praktikisht e pamundur. Marrja e këtij trofeu individual ishte një shpërblim për gjithë punën e vështirë që kisha bërë”, ka përfunduar Cannavaro.

## Leclerc: Pas fitoreve në Montekarlo dhe Monza tani dua titullin kampion

Monza, 11 tetor - Piloti monogask Charles Leclerc ka ide të qarta për të ardhmen e tij në timonin e Ferrarit. Pasi arriti t'i fitojë dy garat e tij të dashura këtë vit, në Montekarlo (shtëpinë e tij) dhe Monza (shtëpinë e Ferrarit), tashmë ai synon titullin e parë kampion. Natyrisht me “kokëkuqen”. “Ka ende shumë punë dhe dua ta bëj me Ferrarin dhe të bëhem kampion bote këtu. Ka qenë ëndrra ime që kur u zgjova në mëngjes. Ne po bëjmë maksimumin për të arritur sa më shpejt të jetë e mundur. Nuk ishte një sezon i lehtë. Ne u rritëm shumë me synimin për të fituar përsëri dhe e bëmë atë”, ka thënë Leclerc. “Ishte një sezon sfidues dhe ne po përpiqemi ta mbyllim diferencën me McLarenin dhe Red Bullin, duke parë drejt e ardhmja. Ne po e realizojmë atë, por ende duhet të bëjmë përparim. Tani dua Kampionatin Botëror me Ferrarin



në kohën më të shkurtër të mundshme”, u shpreh piloti monogask. “Ndihem si viti i parë i Formulës 1 për sa i përket pasionit dhe motivimit. Më pas rritesh si pilot dhe si person, por pasioni ka mbetur gjithmonë i njëjtë. E mbaj mend garën e parë në Ferrari sikur të ishte dje”, ka deklaruar Leclerc, që në fund flet edhe për shokun e tij të

ardhshëm, Lewis Hamilton. “Mezi pres që të arrijë. Çdo shok skuadre ka pika të dobëta dhe të forta për të mësuar. Ai do të ketë shumë pak defekte dhe do të jetë një mundësi e shkëlqyer për të mësuar. Do të jetë shumë interesante, por unë do të mbetem vetvetja dhe ai, si gjithmonë, do të vijë me objektiva të qarta”, ka deklaruar Leclerc.

### SHKURT

#### Trajneri i Empolit: Ismajli është gati për një klub të madh

Trajneri i Empolit, Roberto D'Aversa, ka dhënë një intervistë të gjatë për “Corriere dello Sport”. Trajneri i klubit toskan flet për “xhevahirët” e shumë që kanë spikatur te “të kaltrit”, mes tyre edhe mbrojtësi i kombëtares shqiptare, Ardian Ismajli. “Ismajli tashmë është gati për një klub të madh”, ka thënë trajneri i Empolit. 28-vjeçari shqiptar po bën një sezon të shkëlqyer me skuadrën e tij në kampionatin italian, madje u zgjodh edhe në formacionin e muajit shtator në Serinë A. Ismajli u bashkua me Empolin në verën e vitit 2022 dhe që nga ajo kohë është një titullar fiks i skuadrës toskane.

#### Haalandi thyen rekordin 92-vjeçar në Kombëtaren e Norvegjisë

Erling Haaland, ky emër i destinuar të thyejë çdo rekord, jo vetëm me Manchester Cityn, por po e bën edhe në përfaqësuesen norvegjeze. Ndaj Sllovenisë, Haalandi theu një rekord që qëndronte në fuqi prej 92 vitesh. Me golin e parë të realizuar në minutën e shtatë, Haalandi u shndërrua në golashënuesin më të mirë në historinë e përfaqësueses norvegjeze, kapi kuotën e 34 golave, për më tepër me 36 ndeshje në dispozicion. Me të në formacion, Norvegjia e kishte të lehtë ta zgjidhte ndeshjen pasi me fillimin e pjesës së dytë, Haalandi dhuroi edhe një asistim për t'i dyfishuar shifrat. Biondi nuk u mjaftuan me kaq, por në këtë mbrëmje rekord realizoi edhe golin e tij të dytë personal dhe të tretin për Norvegjinë. Falë formës së shkëlqyer të Haalandit, Norvegjia kryeson Grupin 3 në Ligën B me 7 pikë. Në vendin e dytë me 4 pikë renditet Austria, që mposhtin Kazakistanin me rezultat 4-0.

#### Ylli amerikan i NBA-s: Dua të jem pjesë e kombëtares në Olimpiadën e shtëpisë

Në prag të fillimit të sezonit të ri 2024-2025 të NBA-s, basketbollisti Kyrie Irving, një nga yjet e këtij sporti, ka folur për të ardhmen. Lojtari që aktualisht aktivizohet me Dallas Mavericks ka shprehur dëshirën të jetë sërish pjesë e kombëtares. Dhe këtë gjë kërkon ta bëjë në një event të veçantë si Lojërat Olimprike, që pas katër vjetësh do të zhvillohen në Los Anxhelos. Pra, në shtëpinë e amerikanëve, që do të kërkojnë ta mbrojnë medaljen e artë fituar dy muaj më parë në Paris. “Shpresoj që trajneri të më japë një mundësi kur të vijë koha e Olimpiadës. Kjo është kultura që është krijuar mes nesh në kombëtare mes viteve 2008-2016”, ka thënë Irving, tashmë 32-vjeçar. “Unë vij nga shkolla e Kobe Bryant, LeBron James dhe Jason Kidd. Këta djem më kanë mësuar se çfarë do të thotë të fitosh një mundësi për ta përfaqësuar kombëtaren në një event të madh”, u shpreh më tej Kyrie Irving. “Unë kam ndër mend të luftoj për të pasur një mundësi në Olimpiadën e vitit 2028. Nëse Zoti do të dojë, nëse do të jem në formë, është e sigurt se do të përpiqem të jem në kombëtare”, ka shtuar Irvingu.

Kampion në NBA në vitin 2016 me Cleveland, basketbollisti ka fituar një medalje të artë olimprike në vitin 2016 në Rio. Më herët, në vitin 2014, është shpallur edhe kampion bote me kombëtaren amerikane (në Spanjë).

## Barcelona ka mbi 100 milionë euro borxhe

Problemet financiare të Barcelonës vitet e fundit kanë qenë mirë të dokumentuara dhe, ani pse gjërat dukej se po përmirësoheshin gradualisht, ka ende një rrugë të gjatë për të bërë para se të rivendoset barazia. Shpenzimet mund të

bien, por ka ende një shumë të majme parash që blaugranasit duhet të paguajnë shkaku i transferimeve që kanë kryer më herët. Mediumi spanjoll “Sport” ka dhënë detaje në lidhje me këto figura dhe lojtari që po iu kushton më së shumti është

Raphinha. Në total, Barcelona i ka borxh Leeds Unitedit rreth 42.5 milionë euro nga marrëveshja e cila u arrit në vitin 2022, ani pse vetëm 500 mijë euro duhet të paguhet në një të ardhme të afërt. Në rastin e Ferran Torres, ata i kanë borxh

Manchester Cityt 26 milionë euro, 13 prej të cilave duhet të paguhet në një të ardhme të afërt, ndërsa 13 të tjera afatgjatë. Raste të tjera përfshijnë transferimet e Jules Kounde për të cilin ata i kanë borxh Sevillas rreth 24.5 milionë euro dhe për

Robert Lewandowskin për të cilin disa klube duhet të paguhet, përfshirë Bayern Munich. Barcelona eventalisht duhet t'i shlyejë të gjitha këto borxhe në mënyrë që ta vazhdojë përmirësimin e krizës financiare.

Kompania Rajonale e Mbeturinave  
Regionale "PASTRIMI" S.H.A.  
Nr. br. 5357 dt. 11-10-2024  
Prishtinë - Prishtinë



### KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "PASTRIMI" SH.A

Duke u bazuar në Ligjin Nr. Ligjin Nr. 03/L-212 i Punës konkretisht Neni 8 Udhëzimin Administrativ MFPT Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik konkretisht Neni 5 Paragrafi 1,2 dhe Neni 7, Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, Vendimin e datës 10.10.2024 me numër të protokollit 5712/1 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, shpallë këtë:

#### KONKURS PUBLIK (Për plotësimin e vendit të punës)

**Titulli i vendit të Punës:** "Këshilltar i Kryeshefit Ekzekutiv" në KRM "Pastrimi" SH.A (1) pozitë.

**Departamenti:** Kabineti i Kryeshefit Ekzekutiv

**Numri i Referencës:** KKE/KJ-17/2024

**Koeficienti/Paga mujore:** Niveli V

**Kohëzgjatja e Kontratës së Punës:** Me kohë të pa caktuar,

**Periudha Provuere:** 3 muaj

#### 1. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Ofron ndihme KE në zhvillimin e politikave që lidhen me Kompaninë;
- Ofron ndihmë KE në zbatimin e politikave;
- Harton draft dokumente sipas nevojës dhe kërkesës së KE;
- Harton Draft Vendime dhe shkresa për nevojat e zyrës së KE;
- Angazhohet në konsultime një-një ose në grup për të kuptuar nevojat specifike, sfidat dhe qëllimet e zyrtarëve brenda kompanisë;
- Ofron këshilla për stafin e kompanisë;
- Kryen analiza të thella duke bërë vlerësime për situatën aktuale dhe ofron rekomandime;
- Komunikon qartë idetë dhe rekomandimet, si verbalisht ashtu edhe me shkrim;
- Kryen dhe punë të tjera të përcaktuara nga KE
- Për punën e tij i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

#### 2. Kriteret e përgjithshme për pranim në detyrë:

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- ✓ Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën
- ✓ Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

#### 3. Kërkesat e përgjithshme formale

- ✓ **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë Universitare në fushën Ekonomike, Juridik
- ✓ **Përvoja e punës e kërkuar:** 3 vite përvojë profesionale

#### 4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- ✓ Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- ✓ Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- ✓ Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- ✓ Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- ✓ Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

#### 5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- ✓ Aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati,
- ✓ Kopje të diplomave të dhëna nga Institucionet Arsimore,
- ✓ Kopje të dëshmisë së punësimit ( Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës),
- ✓ Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve,
- ✓ Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit, (E dëshirueshme).
- ✓ Kopje të Letërnyoftimit,
- ✓ Vërtetimin që nuk është i dënuar për kryerjen e një veprës penale jo më të vjetër se 3 muaj.

#### 6. Mënyra e aplikimit në konkurs:

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në Zyret e Burimeve Njerëzore në KRM "Pastrimi" SH.A.

Të gjitha aplikimet duhet të bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet platformës elektronike; [punesimi.krmpastrimi@gmail.com](mailto:punesimi.krmpastrimi@gmail.com)

#### 7. Data dhe ora e saktë e përmbylljes së Konkursit Publik:

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 12.10.2024 deri me datën 26.10.2024. Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00 të datës 26.10.2024.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

#### 8. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të CV-së, testit shkrim dhe me intervistim ( testi me gojë).

- ✓ CV-ja e kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë,
- ✓ Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë,
- ✓ Intervista ( testi me goje) vlerësohet deri në njëzetë (20) pikë.

Procedura e vlerësimit përmban gjithësejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

#### 9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimit elektronik dhe individualisht.

#### 10. Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Konkursi Publik i hapur deri me datën 26.10.2024.

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri 7 ditë,

Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,

Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.

Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistë.

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Bletaria Natyral" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr: 330459257.

- Adlije Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u "Hamëz Cena" Damjan nga kl. 1-5,6-9.

- Selviye Hoti shpall të pavlefshme diplomën e SHML "Eçrem Çabej" në Prishtinë.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

Kompania Rajonale e Mëturinave  
Regjistruarë në Sektorin e Zgjedhur të Opatitë  
"PASTRIMI" sh.a.d.d.  
Nr.br. 5957 dt. 11.10.2024  
Prishtinë - Prishtinë



### REGIONALNO PREDUZEÇE ZA OTPAD "PASTRIMI" SH. A

Na osnovu Zakona br. 03/L-212 o radu, člana 8. Administrativne instrukcije FPT br. 01/2024 o uređenju konkursnih postupaka u javnom sektoru, posebno člana 5. stav 1,2 i člana 7. Uredbe br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u KRM "Pastrimi" SH. A, Odluka od 10.10.2024. godine sa brojem protokola 5712/1 izvršnog direktora KRM "Pastrimi" SH. A onda, proglasite ga:

#### Takminenje (Za završetak radnog mesta)

**Naziv posla:** "Savetnik izvršnog direktora" u KRM "Pastrimi" SH, (1) pozicija,

**Sektor:** Kabinet izvršnog direktora

**Poziv na broj:** KKE/KJ-17/2024

**Koeficijenti / Paga mujore:** Niveli V

**Trajanje ugovora:** Bez fiksnog vremena,

**Periodha Provuese:** 3 ponude

#### 1. Dužnosti i odgovornosti:

- Pruža pomoć EK u razvoju politika koje se odnose na Kompaniju;
- Pruža pomoć u sprovođenju politika;
- Izrađuje dokumente u skladu sa potrebama i zahtevima EK;
- Nacrti odluka i dokumenata za potrebe Kancelarije Evropske komisije;
- Uključite se u jedan-na-jedan ili grupne konsultacije kako biste razumeli specifične potrebe, izazove i ciljeve zvaničnika unutar kompanije;
- Pružite savete osoblju kompanije;
- Sprovodi dubinsku analizu tako što procenjuje trenutnu situaciju i daje preporuke;
- Komunicirajte ideje i preporuke, usmeno i pismeno;
- Obavljanje drugih poslova definisanih od strane EK.
- On je odgovoran izvršnom predsedavajućem.

#### 2. Opšti kriterijumi za prijem na dužnost:

- ✓ da bude državljanin Republike Kosovo,
- ✓ Da imaju punu sposobnost da deluju, u skladu sa važećim zakonima;
- ✓ da poseduje najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- ✓ Biti u stanju da izvrši odgovarajući zadatak;
- ✓ Da ne bude osuđen za izvršenje krivičnog dela;
- ✓ Imaju obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i / ili veštine potrebne za poziciju
- ✓ Uspešno proći procedure prijema utvrđene u ovom zakonu.

#### 3. Opšti formalni zahtevi

- ✓ **Potrebno obrazovanje:** Visoka stručna sprema ekonomije, pravo
- ✓ **Potrebno radno iskustvo:** 3 godine profesionalnog iskustva

#### 4. Znanje, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja

- ✓ Sposobnost logičkog zaključivanja i analize;
- ✓ Komunikacijske veštine i lični uticaj, uključujući sposobnost predstavljanja.
- ✓ istraživanje, analitika, evaluacija i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- ✓ sposobnost donošenja nezavisnih stručnih presuda i ostvarivanja diskrecionog prava o pitanjima i davanja značajnog doprinosa razvoju i sprovođenju politike;
- ✓ Opsežno poznavanje oblasti, istraživačkih metoda, koje pomažu u pripremi osnovnih ili analitičkih izveštaja;

#### 5. Dokumenti koji se podnose u okviru prijave i način njihovog podnošenja

- ✓ Prijava popunjena i potpisana od strane kandidata,
- ✓ Kopija diploma koje su izdale obrazovne institucije,
- ✓ Kopija potvrde o zaposlenju (penzioni fond, potvrda ili ugovor o radu),
- ✓ Dokazi o obukama i kursovima,
- ✓ Kopija procene rada za poslednje dve godine, (poželjno).
- ✓ Kopije lične karte,
- ✓ Uvjerenje da nije osuđen za počinjenje krivičnog djela ne starijeg od 3 meseca.

#### 6. Način prijavljivanja na konkurs:

Zainteresovani kandidati, zvanični obrazac se može dobiti u kancelarijama za ljudske resurse u RM "Pastrimi" SH.A.  
Sve prijave moraju biti podnete elektronskim putem samo putem elektronske platforme; punesimi.krmpastrimi@gmail.com

#### 7. tačan datum i vreme završetka javnog konkursa:

Javni konkurs traje 15 dana od 12.10.2024. do 26.10.2024. godine. Poslednji put prijema prijava je 26.10.2024. godine u 16:00 časova.

Sve prijave koje stignu nakon isteka roka neće se razmatrati.

#### 8. Način vrednovanja i kriterijumi vrednovanja.

Ocenjivanje kandidata vrši se na osnovu biografije, pismenog testa i intervjuja (usmeni test).

- ✓ CV kandidata je ocenjen do deset (10) bodova,
- ✓ Pismeni test se vrednuje do sedamdeset (70) bodova,
- ✓ Intervjua (usmeni test) se procenjuje na dvadeset (20) bodova.

Postupak vrednovanja sadrži sto (100) bodova, pri čemu je past postizanje najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza javnog konkursa.

#### 9. Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima.

Svi kandidati će biti obavesteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

#### 10. Približan raspored postupka zapošljavanja:

Javni konkurs otvoren do 26.10.2024.

Preliminarna faza verifikacije prijave do 7 dana,

Faza pismenog testiranja do 10 dana nakon faze verifikacije,

Faza intervjuja do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa.

Objavlivanje rezultata do 5 dana nakon evaluacije intervjuja.

**Napomena:** Nesastavljeni, neskenirani dokumenti i oni koji stignu nakon isteka roka za konkurs neće biti pregledani.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  [www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

---

# SWISS

## TAVERNA

---

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

